



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 dhe 17 alineja 1 nën pikën c dhe f) si dhe nenit 40 të Ligjit të Vet- qeverisjes Lokale 03/L-040, dispozitat e Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme nr.03/L-139, nenit 10 nën pikën e 40 të Statutit të Komunës, me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente 01 Nr.06-7013 të datës 25/02/2021, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-te të rregullt të mbajtur më datën 26.02.2021, merr këtë:

### V E N D I M

Për

Shpallje “Zonë me Interes Publik” parcelën nr.P-71010080-00109-2, ZK Çabiq

- I. Miratohet vendimi për Shpalljen “Zonë me Interes Publik” parcela nr.P-71010080-00109-2, ZK Çabiq, pronë private në emër të Zelfije Milazim Bashotës.
- II. Vendimi si në pikën I(një) behët me qëllim të ndërtimit të rezervuarit akumulues për furnizim me uji të pijshëm me kapacitet 1000 m<sup>3</sup>(kub) ujë dhe vazhdimin të procedurave tjera ligjore deri në finalizimin e projektit.
- III. Kompetent për vazhdimin e procedurave lidhur me shpronësimin e parcelës se lartcekur është Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

Me këtë vendim njoftohet: MPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-7775 /2021  
Klinë, me 04.03. /2021



Kryesuesi,  
Fadil Gashi



Na Na osnovu člana 12. i 17, podstav 1, pod tačkama c i f), kao i člana 40. Zakona o lokalnoj samoupravi 03 / L-040, odredbe Zakona o eksproprijaciji nepokretne imovine br. 03 / L-139 , član 10. pod tačkom 40. Statuta opštine, i na zahtev Direkcije javnih i hitnih službi 01 br. 06-7013 od 25.02.2021, Skupština Opštine Klina u II redovnoj sednici održanoj 26.02. 2021, uzima sledeću:

### ODLUKU

za

#### Proglasanja kao Područje od javnog interesa parcelu broj P-71010080-00109-2, KZ Çabiq

- I. Usvaja se odluka za proglašenje „Područje od javnog interesa“ parcela broj P-71010080-00109-2, CZ Cabic, privatno vlasništvo na ime Zelfije Milazim Bashota.
- II. Odluka kao u tački 1 (jedan) donosi se u cilju izgradnje akumulacionog rezervoara za snabdevanje vodom za piće kapaciteta 1000 m<sup>3</sup> (kubika) vode i nastavka ostalih zakonskih postupaka do finalizacije projekta.
- III. Nadležan za nastavak postupaka u vezi sa eksproprijacijom gore navedene parcele je gradonačelnik u saradnji sa Direkcijom javnih i hitnih službi.
- IV. Oko ovog projekta, Konzorcijum DORCH / CDI je dodelio neophodni budžet za izgradnju ovog vodovoda.

### SKUPŠTINA OPŠTINE KLINA

01Br. 06-1775 / 2021  
Klina, 04/03 / 2021



Predsedavajući  
Fadil Gashi

S.T.



**PËR:** Kuvendin e Komunës së Klinës, Kryesuesin, z. Fadil Gashi;  
**KOPJE:** Shërbimin për punë të kuvendit, znj. Grishe Gashi;

**NGA:** Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, z. Iber Elezaj;

**PËRMES:** Kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj;

**LËNDA:** Propozim, për futje në rend të ditës marrjen e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçante me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-2, ZK Qabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashota, ku planifikohet të ndërtohet rezervuari akumulues për furnizim me ujë të pijshëm me kapacitet 1000m<sup>3</sup> ujë.

*Të nderuar Anëtar të Asamblesë Komunale,*

Duke marrë parasysh faktin së Komuna e Klinës dhe në veçanti vendbanimet si; Cerovik, Gllarevë, Stapanicë, Rixhevë, Zaberxhë, Qabiq, Gjurgjevik i Madhë e Gjurgjevik i Vogël, Perqevë, Dobërdol e Stupë, përballet me mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm dhe për nevoja të amvisërisë, Konzorciumi DORCH/CDI ka hartuar projektin detaj si dhe ka ndarë buxhetin e nevojshëm në vlerë prej 1,500,000.00€uro për ndërtimin e ujësjellësit për këto 11 fshatra.

Mbi këtë gjendje kërkojmë nga Kuvendi i Komunës, që në këtë seancë të futet si pikë e rendit të ditës marrja e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçante me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-2, ZK Qabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashota, ku planifikohet të ndërtohet rezervuari akumulues për furnizim me ujë të pijshëm me kapacitet 1000m<sup>3</sup> ujë dhe vazhdimin të procedurave tjera ligjore deri në finalizimin e projektit.

Duhet theksuar së në parcelën e njëjtë është i ndërtuar edhe një rezervuar tjetër nga Komuna e Klinës, mirëpo nuk është arritur që të funksionalizohet për mungesë të burimit të ujit, ndërsa me projektin e ri do të jetë në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe pjese e projektit në zhvillim.

Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së bashku me materialin e nevojshëm.

*Me respekt,*

01 Nr. 06-2013 /2021  
Klinë, dt.25/02/2021



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Bashotaj Zelfije

Zyrtarësh

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	11-3577-2020
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	18.12.2020 - 09:08
Komuna / Opština / Municipality:	Klinë / Klina / Klinë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Klinë / Klina / Klinë

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Bashotaj	Zelfije	Milazim	Femër / Zensko / Female	1013473150	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO	10.05.1951	01.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
CARAVIK / CEROVIK / CEROVIKU		Caravik	Caravik	

**B. NJËSIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT**

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytezimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71010080-00109-2	Klinë / Klina / Klinë	ÇABIQ / ÇABIĆ / ÇABIQI	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land / R		KODRA E ZENELIT-LUGI I RIJ / KODRA E ZENELIT-LUGI I RIJ / KODRA E ZENELIT-LUGI I RIJ	9848	Pyjor - Tokat Pyjore - Mal I Klasës 3 / / šumsko - šumsko zemljište - Suma 3 Klase / / Forestry - Forest - 3rd Class Forest / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	01.12.2020





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN


Zyrtarishit

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KLINË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çabiq

Nr. M-3577

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71010080-00109-2	Parcelë / Parcela / Parcel	9848



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1331

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 18.12.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:18:22

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

*Flajdedin Gashi*

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Për: Komuna e Klinës

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

Nga: Konzorciumi DORSCH/CDI

Lënda: "Kërkesë për shfrytëzimin e parcelës për ndërtimin e Rezervuarit të ujit në fshatin Çabiq – Komuna e Klinës"

Datë: 16.11.2020

Përshëndetje të nderuar,

Konzorciumi Dorsch/CDI është implementues i donacioneve të Qeverisë Zvicerane dhe të Qeverisë së Kosovës në "Programi Mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza e VI-të".

Në kuadër të këtij programi është paraparë të ndërtohet edhe një sistem i përbashkët i ujësjellësit për 11 fshatra të komunës së Klinës.

Së bashku me KRU "Hidrodrini" si partner kyç i programit tonë dhe me Komunën e Klinës jemi pajtuar që ky sistem të furnizohet me ujë nga burimet e Jarinës dhe me anë të Stacionit të Pompimit të dërgoj ujin tek Rezervuari kryesor prej 1000 m<sup>3</sup> i cili parashihet të ndërtohet në zonën kadastrale të Çabiq në kuotën 725,00 m.

Ky sistem i përbashkët i ujësjellësit përbëhet prej rreth 80,000m rrjet të ujësjellësit primar dhe sekondar, një Stacion të Pompimit në Ujëmir, klōrinatorin, nga një Rezervuar prej 100m<sup>3</sup> në Pogragjë dhe Jarinë si dhe rezervuarin kryesor në Çabiq prej 1000m<sup>3</sup>.

Konzorciumi DORSCH/CDI ka hartuar projektin detaj si dhe ka ndarë buxhetin e nevojshëm për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për këto 11 fshatra.

Buxheti i planifikuar për këtë projekt është 1,500,000.<sup>00</sup> EURO.

Nga Komuna e Klinës kërkohet që të zhvillojë të gjitha procedurat e nevojshme të parapara me ligj për të shpallur zonë të interesit publik lokacionin e paraparë për ndërtimin e Rezervuarit kryesor.

Sipas projektit detal, parcela e paracaktuar ku do të ndërtohet impianti është si më poshtë:

**PARCELA E PROPOZUAR:**

Parcelat sipas <http://geoportal.rks-gov.net/> (e hijezuar me të verdhë në Aneksin 1)

**Njësia kadastrale:** P-71010080-00109-2;

**Vendbanimi-adresa:** Kodra e Zenelit – Lugi i Rij; Çabiq

**Pronari:** BUZHALA MARTIN (GJERGJ)



Halil Berisha

  
Udhëheqës – Njësia Klinë

**ANNEX 1:**



*Lokacioni i propozuar për ndërtimin e Rezervuarit kryesor 1000m<sup>3</sup>*

